



BULETIN



RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin dyjavor / Nr.9

Gusht 2004

Projekt i Qendrës së Studimeve Parlamentare dhe Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (SOROS)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

I. Materiale të shqyrtuara e të miratuara në mbledhjen e Këshillit të Ministrave më datën 2. 7. 2004

PROJEKTLIGJE

(Vendime për propozime projektligjesh Kuvendit të Shqipërisë).

1. Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar.

2. Për eficientë e energjisë.

-Projektligji propozohet nga ministri i Energjitikës dhe synohet të nxitet rritja dhe përmirësimi i eficientës së energjisë elektrike, në funksion të rritjes së sigurisë së furnizimit me energji.

3. Për sistemin e adresave.

- Synohet t'i jepet fund gjendjes kaotike të adresave. Projektligji përcakton detyra

(Vijon në faqen 2)

Ftesë e Hapur për Bashkëpunim

Ministria e Ekonomisë në mbështetje të:

Ligjit Nr. 8810, datë 17.05.2001 "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "Albtelecom";

Ligjit Nr.9127, datë 29.07.2003 "Për disa shtesa në ligjin nr.8810 datë 17.05.2001 "Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "Albtelecom";

Ligjit Nr.9117, datë 24.07.2003, "Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "Armo Fier";

dhe të programit të punës së Qeverisë Shqiptare ka përgatitur draftin e paketës së akteve nënligjore për privatizimin e dy shoqërive të rëndësishme që funksionojnë në sektorët strategjikë të ekonomisë shqiptare,

(Vijon në faqen 6)

**Në këtë numër
do të lexoni:**

**1. Nga Mbledhjet e
Këshillit të Ministrave
faqe 1-3**

**2. Informacion mbi faqet
e internetit të
Institucioneve Qendrore
faqe 1**

**3. Ftesë e Hapur për
Bashkëpunim
faqe 1 dhe 6**

**4. Nga punimet e
Kuvendit për periudhën
1-15 korrik 2004
faqe 4-5**

Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qendrore

Kuvendi i Shqipërisë
www.parlament.al

Këshilli i Ministrave
www.keshilliministrave.al

Presidenca
www.president.al

Bashkia e Tiranës
www.tirana.gov.al

Ministria e Arsimit dhe e
Shkencës
www.mash.gov.al

Ministria e Punëve të Jashtme
www.mfa.gov.al

Ministria e Shëndetësisë
www.moh.gov.al

Ministria e Rendit Publik
www.mpo.gov.al

Ministria e Pushtetit Vendor
dhe Decentralizimit
www.mpvd.gov.al

Ministria e Transportit dhe
Telekomunikacionit
www.mtt.gov.al

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 1)

për pushtetin qendror dhe atë vendor dhe vë afate për kryerjen e tyre.

Vendime të Këshillit të Ministrave

1. "Për përcaktimin e madhësisë së paketës së aksioneve të kapitalit të shoqërisë anonime "Albtelekom" që u ofrohet investitorëve strategjikë".
2. "Për kriteret e vlerësimit të ofertave për privatizimin e shoqërisë anonime "Albtelekom".
3. Për mënyrën e transferimit të paketës së aksioneve të mbetura të shoqërisë anonime "Albtelekom", pas transferimit të paketës tek investitorët strategjikë, "Albapost" sha-ja, ish pronarët e truallit dhe punonjësit e shoqërisë anonime "Albtelekom".
4. Për masën e përdorimit të të ardhurave nga privatizimi i shoqërisë anonime "Albtelekom".
5. Për një shtesë në vendimin nr.653, datë 21.11.2001 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e përzgjedhjes së investitorëve strategjikë, të interesuar për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime "Albtelekom".
6. Për kriteret e përzgjedhjes së investitorëve strategjikë, të interesuar për blerjen e aksioneve të "ARMO" sha-së Fier.
7. Për kriteret e vlerësimit të ofertave për privatizimin e "ARMO" sha-së Fier.
8. Për mënyrën e përdorimit të të ardhurave nga privatizimi i "ARMO"sha-së Fier.

9. Për disa shtesa dhe ndryshime në vazhdimin nr. 43, datë 17.11.1998 të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin e pasurive dhe të depozitave tregtare" (të ndryshuar).

10. Për rritjen e pensioneve.

11. Për rritjen e pensioneve suplementare të ushtarakëve dhe të pensioneve familjare të pilotëve, që kanë humbur jetën në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit.

12. Për disa ndryshime në vendimin nr.402, datë 11.6.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar.

13. Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të drejtorive arsimore rajonale dhe zyrave arsimore.

14. Për miratimin e kriterëve dhe të normave të trajtimit me uniformë, të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

15. Për kalimin e portit të peshkimit, Shëngjin, në administrim të Ndërmarrjes së Rritjes së Midhjeve, Sarandë.

16. Për disa shtesa në vendimin nr.392, datë 15.8.2002, të këshillit të Ministrave "Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor

Rrogozhinë-Elbasan, në Qarkun e Elbasanit.

17. Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi, për organizimin e trafikut kufitar hekurudhor ndërmjet të dyja vendeve.

18. Për njesimin e gradave ushtarake në funksionet organike në të gjitha nivelet e hierarkisë së komandimit dhe të drejtimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

19. Për kriteret e gradimit të oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve rezervistë.

II. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 9. 7. 2004

PROJEKTLIGJE

(miratim vendimi për propozimin e projektligjit) 1. "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik".

- Ky projektligj është një rishikim tërësor i ligjit në fuqi për barnat, i vitit 1994 për të bërë atë më bashkëkohor dhe të zbatueshëm, për thellimin e reformave, nxitjen dhe inkurajimin e biznesit, duke garantuar cilësinë dhe sigurinë e barnave dhe duke përmirësuar tërësisht shërbimin farmaceutik.

2. "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve."

- Projektligji synon plotësimin e mangësive dhe boshllëqeve të legjislacionit në

(Vijon në faqen 3)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 2)

fuqi, përfshirjes në të, të çështjeve të reja, si dhe përafrimin e legjislacionit tonë me atë të Bashkimit European për të krijuar hapsirën për nxjerrjen e akteve nënligjore sipas standardeve të Komunitetit European.

3. "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8981, datë 12.12.2002 "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore (i ndryshuar)".

- Me këtë projektligj synohet të nxitet përdorimi i mëtejshëm i gazit si burim alternativ energjie për nevoja rezidenciale apo shërbime publike.

VENDIME të Këshillit të Ministrave.

1. "Për financimin e programeve kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit për vitin 2004".

2. "Për miratimin e tarifave të shkollave pasuniversitare (SHPU) të Universitetit Politeknik të Tiranës".

3. "Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.601, datë 17.11.2000 "Për një shtesë në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për dhënien e pagës së trembëdhjetë të punonjësve mësimorë të sistemit pasuniversitar".

4. "Për përcaktimin e gjendjes së të sëmurit që ka nevojë për ndihmë mjeksore urgjente si dhe dokumentacioni i duhur për mbulimin e shpenzimeve të bëra".

5. "Për disa ndryshime në vendimin nr.70, datë

15.2.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për statusin e spitaleve universitare".

6. "Për financimin e Urdhrit të Farmacistëve për një periudhë njëvjeçare".

7. Për kuotën e pranimit të studentëve në Universitetin Ushtarak "Skënderbej", për vitin akademik 2004-2005.

8. Për kriteret e dhënies së kredisë për strehimin e ushtarakut të forcave të Armatosura, të Republikës së Shqipërisë dhe masën e kësaj kredie.

9. Për kriteret dhe masën e trajtimit financiar të ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura, kur lirohet nga shërbimi në këto forca, për arsye shëndetësore.

10. Për transferimin në pronësi të Bashkisë së Delvinës të mjediseve të ish-brigadës së këmbësorisë në Delvinë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes.

11. Për transferimin në pronësi të Bashkisë së Laçit të mjediseve të ish Repartit Ushtarak nr. 1022 në Laç, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një ndryshim në VKM nr. 515 datë 18.7.2003 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme sh-

tetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".

12. Për ndryshimin dhe kalimin e përgjegjësisë së administrimit të objektit të parkut të automjeteve dhe fjetores së repartit "Renea", Tiranë, nga Ministria e Rendit Publik, Ministrisë së Drejtësisë.

13. Për ndryshimin e përgjegjësisë të administrimit të mjediseve të Agjencisë për Zhvillimin Ekonomik sha, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë, për sistemimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare.

14. Për dhënie mendimi Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për projektligjin joqeveritar "Për disa masa në mbrojtje të mjedisit".

15. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për financimin e zgjedhjeve të pjesëshme për kryetar komune, në komunën Market të Qarkut të Vlorës.

16. Për dhënie fondi ndihme disa partive politike të reja.

17. Për dhënien e një fondi prefektit të qarkut të Gjirokastrës.

18. Për një shtesë fondi Ministrisë së Rendit Publik për dhënie ndihme financiare familjes së z. Fran Bardhok Lleshi, ish polic, i vrarë për shkak të detyrës.

NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 1-15 KORRIK 2004

1. P/ligji “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, ndryshuar me ligjin nr.7771, datë 7.12.1993” (miratuar në seancë plenare më 15 korrik 2004)

Kuvendi rifilloi shqyrtimin e këtij projektligji, duke u bazuar edhe në opinionet e dërguara nga përfaqësues të Komisionit Europian për Demokraci Njëpërmjet Ligjit (Komisionit të Venecias) lidhur me përvojën e legjislacionit hungarez dhe lituanes për kompensimin e personave që u është hequr jeta dhe liria në mënyrë të kundërligjshme për arsye politike. Diskutimet për këtë projektligj u përqëndruan në çështjen e kompensimit financiar të ish-të dënuarve politikë. Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit dëgjoi në një mbledhje të tij përfaqësuesit e shoqatave të ish-të përndjekurve politikë, të cilët kërkuan që masa e shpërblimit të ish-të përndjekurve politikë për çdo ditë burg të bëhet në bazë të Kodit Penal. Ndërkohë, Ministri i Financave informoi Komisionin për kompensimin e kryer në favor të ish-të përndjekurve politikë gjatë viteve 1993-1997 në formën e kompensimit financiar për ditët e burgut, letrave me vlerë të privatizimit, të drejtave të studimit, blerjes dhe ndërtimit të banesave, pensioneve, kredive lehtësuese nga sistemi bankar etj. Ai konfirmoi angazhimin e Qeverisë shqiptare për gjetjen e një skeme kompensimi të arësyeshme për ish-të përndjekurit politikë, por edhe të mundshme për t’u realizuar nga Buxheti i Shtetit, brenda burimeve të kufizuara financiare të tij. Lidhur me ndërtimin e një skeme kompensimi të plotë dhe të mbështetur financiarisht, ai informoi deputetët se ka një problematikë, e cila buron nga kontradikta në numrin e ish-të dënuarve për motive politike, i cili sipas informacionit të marrë nga Ministria e Drejtësisë është 9807 vetë, ndërsa sipas Institutit të Integritetit të ish-të Përndjekurve Politikë është 23 963 vetë. Po

kështu, edhe numri i të pushkatuarve sipas Ministrisë së Drejtësisë është 639 vetë, ndërsa sipas Institutit të Integritetit të ish-të Përndjekurve Politikë është 6 027 vetë. Ai propozoi një skemë kompensimi në dy variante, sipas këtyre dy burimeve të informacioneve. Më pas, Kuvendi u njoh me mendimin e Këshillit të Ministrave për projektligjin, i cili vëren disa probleme të teknikës legjislative dhe kundërshti me akte të ndryshme ligjore, por kryesorja është që efekti financiar që rrjedh nga ky projektligj është 136 miliardë lekë dhe nuk mund të përballohet nga Buxheti i Shtetit. Këshilli i Ministrave u shpreh dakord ta mbështesë këtë nismë ligjore, duke propozuar që shpërblimi të jetë në formën e një pagese mujore, që ndryshon nga 1000 në 5 000 lekë në muaj, në varësi të kohëzgjatjes së vuajtjes së dënimit. Shuma maksimale prej 5 000 lekësh në muaj propozohet të zbatohet për familjet e të pushkatuarve. Sipas skemës së propozuar nga Këshilli i Ministrave, kostoja financiare vjetore llogaritet në rreth 200 milionë lekë dhe është e përballueshme nga Buxheti i Shtetit. Ajo do të parashikohet për shumë vite në Buxhetin e Shtetit.

Përfaqësuesit e opozitës e kundërshtuan skemën e kompensimit të ish-të dënuarve politikë të propozuar nga Këshilli i Ministrave, me argumentin se masa e kompensimit financiar që propozohet sipas kësaj skeme është mjaft e ulët dhe është shumë larg asaj që kërkohet në projektligj. Për këtë arsye, ata u larguan nga salla e Kuvendit gjatë votimit të projektligjit. Në përfundim, Kuvendi e miratoi projektligjin me shumicë votash, duke marrë për bazë skemën e kompensimit financiar të ish-të dënuarve politikë sipas propozimit të Këshillit të Ministrave.

2. P/ligji “Për miratimin e Kodit Detar Shqiptar” (miratuar në seancë plenare më datë 8 korrik 2004)

(Vijon në faqen 5)

NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 1-15 KORRIK 2004

(Vijon nga faqja 4)

Projektligji synon krijimin e një kuadri të plotë ligjor për fushën e detarisë, duke pasqyruar në të detyrimet që rrjedhin nga aderimi në konventat ndërkombëtare për detarinë.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komisionin e Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjeve deputetët u shprehën dakord me të në parim dhe propozuan ndryshimin e një sërë dispozitave me synim përmirësimin e përmbajtjes së tij.

Ndryshimet që u propozuan në pjesën e përgjithshme të projektligjit synojnë të përmirësojnë përmbajtjen e dispozitave që krijojnë kundërshti me ligje të tjera dhe njëanshmëri në zbatimin e tij, duke i dhënë Kodit natyrën e një ligji që zbatohet nga një ministri. Gjithashtu, rregullimet që bëhen në disa dispozita të pjesës së përgjithshme synojnë t'i japin Kodit natyrën e një ligji që parashikon rregulla të përgjithshme, duke shmangur hollësitë dhe rregullimet e veçanta teknike, të cilat mund të parashikohen në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave. Në këtë kuadër, Komisioni e konsideron të tepërt parashikimin në Kod të strukturës administrative që krijohet në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit për të ndjekur zbatimin e tij. Përmirësimet në dispozita synojnë edhe pasqyrimin më të plotë e më të saktë të detyrimeve të shtetit shqiptar që rrjedhin nga aderimi në Konventën mbi të Drejtën e Detit.

Kuvendi e miratoi projektligjin mbi bazën e vërejtjeve të Komisionit të Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjeve.

3. P/ligji “Për një shtesë në ligjin nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” (miratuar në seancë plenare më datë 8 korrik 2004)

Ky projektligj është paraqitur nga një grup deputetësh dhe synon ndalimin e importimit të mbetjeve urbane të ngurta, me qëllim përdorimi si lëndë djegëse ose për prodhim energjie

elektrike, i cili është me pasoja mjedisore. Ai ka për qëllim t'i presë rrugën importimit të jashtëligjshëm të mbeturinave urbane nga vende të tjera për t'u përpunuar në vendin tonë. Komisioni i Përhershëm i Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjeve në mbledhjen e tij dëgjoi edhe mendimet e përfaqësuesve të lëvizjes “Mjaft”, të cilët ishin përkrahës të kësaj nisme ligjvënëse dhe në përfundim të diskutimit, u shpreh dakord me projektligjin.

Por kjo nismë ligjvënëse nuk gjeti përkrahjen e anëtarëve të Komisionit të Përhershëm të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe të pjesës më të madhe të deputetëve, të cilët ishin të mendimit se ligji nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” ndalon importimin e çdo lloj mbetjeje urbane për t'u asgjësuar në Shqipëri dhe se ky projektligj nuk sjell ndonjë masë më të fortë mbrojtëse për mjedisin tej atyre që parashikon ligji ekzistues. Për më tepër, ata theksuan se ky projektligj mund të krijojë keqinterpretime në zbatimin e ligjit, pasi ai mund t'i hapë rrugë ndalimit të importimit të disa lëndëve të domosdoshme, si dhe ndalimit të djegjes së disa lëndëve si gazoile, mazute, gaze të lëngshëm etj për prodhim energjie elektrike, të cilat janë bazë e veprimtarisë së TEC-eve. Në përfundim të diskutimit, Kuvendi nuk e miratoi projektligjin me shumicë votash.

Ftesë e Hapur për Bashkëpunim

(Vijon nga faqja 1)

Albtelekom Sh.A. dhe ARMO Sh.A. Kjo paketë, e cila sipas ligjeve të mësipërme do të miratohet nga Këshilli i Ministrave, është hartuar duke u bazuar në përvojat më të mira ndërkombëtare si dhe në funksion të një privatizimi sa më të suksesshëm me synim realizimin e një procesi transparent, me pjesëmarrje të gjerë dhe konkurrese i cili do të garantojë realizimin e investimeve të domosdoshme për zhvillimin afatgjatë të këtyre shoqërive dhe ekonomisë shqiptare. Nëpërmjet kësaj pakete aktesh nënligjore përcaktohen madhësia e paketës që do t'u ofrohet investitorëve strategjikë, kriteret e vlerësimit të ofertave për privatizimin e dy shoqërive dhe çështje të tjera që lidhen me përdorimin e të ardhurave nga procesi i privatizimit.

Duke vlerësuar rolin tepër të rëndësishëm që këto shoqëri kanë për ekonominë e vendit, Ministria e Ekonomisë, në kuadër të transparencës me publikun, hap këtë proces bashkëpunimi më të gjitha palët e interesuara për të dhënë kontributin e tyre në këtë drejtim.

Nëse ju jeni një organizatë, institucion, shoqatë, pedagog, student, jurist, ekonomist, inxhinier apo

çdo individ, brenda apo jashtë Shqipërisë, që mendoni se mund të jepni kontributin tuaj për përmirësimin ekësaj pakete të rëndësishme aktesh nënligjore, jeni të ftuar për të paraqitur idetë tuaja duke marrë pjesë në këtë bashkëpunim të hapur i cili do të vijojë dhe me një konferencë kombëtare mbi këtë temë, që do të zhvillohet së shpejti nga Ministria e Ekonomisë.

Për të marrë falas një kopje të paketës ju mund të:

Dërgoni një kërkesë me shkrim pranë Ministrisë së Ekonomisë.

Kërkoni me telefon ose faks në numrat tel 36 46 33 / 36 46 39 që një kopje t'ju vihet në dispozicion.

Dërgoni një mesazh elektronik në:

privatizim_transparent@miek.gov.al dhe ne do t'ju përgjigjemi duke ju dërguar paketën në formë elektronike.

Kaloni pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe mund të merrni një kopje të paketës në zyrën nr.14, kati V.

Duke çmuar kontributin tuaj dhe falenderuar për bashkëpunimin, mirëpresim çdo sugjerim, koment apo vërejtje për këtë paketë aktesh nënligjore, të rëndësishme për procesin e privatizimit dhe zhvillimin afatgjatë të ekonomisë shqiptare.

Njoftim

Të nderuar zonja e zotërinj, Kuvendi i Shqipërisë me datë 30.06.1999 ka miratuar ligjin nr.8503 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare". Ky ligj rregullon të drejtën e informimit për çdo person dhe krijon mundësinë për të marrë informacion mbi dokumentat zyrtare. Ligji përcakton gjithashtu detyrimin e autoriteteve publike për krijimin e lehtësirave dhe ngritjen e strukturave praktike që publiku i gjerë të marrë në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë, informacionin mbi dokumentat zyrtare.

Autoriteti publik vihet në lëvizje me kërkesë të personit të interesuar dhe është i detyruar të krijojë atij të gjitha mundësitë e përcaktuara në këtë ligj, për dhënien e informacionit të kërkuar. Njëkohësisht autoriteti publik që nga momenti i depozitimit të kërkesës është i detyruar, brenda një kohe të përcaktuar në ligj, ta plotësojë atë.

Ligji i jep të drejtën çdo personi të interesuar të ankohet, kur e drejta për informim shkelet nga autoriteti publik. Për të realizuar këtë, ligji përcakton mënyrën dhe rrugët që ky ankim mund të ndiqet nga subjekti i interesuar. Kjo rrugë mund të jetë administrative dhe gjyqësore.

Për të realizuar sa më mirë këtë të drejtë të njohur nga Ligjvënësi Shqiptar, Qendra e Studimeve Parlamentare "QSP" në Tiranë njofton të gjithë të interesuarit si më poshtë;

"Të gjithë individët dhe organizatat të cilët janë viktimë e mohimit të së drejtës për informim, shkeljes së dispozitave të ligjit nr.8503 dt.30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare" do të kenë mundësinë që, pranë QSP, të marrin asistencë ligjore nga një avokat. Avokati pranë kësaj njësie, do të jetë në dispozicion të subjekteve të sipërpërmendur nga e Hëna në të Enjte ora 15.00 – 17.30

Çdo subjekt i tillë, apo që kërkon informacion më të gjerë mbi këtë të drejtë të saksionuar me ligj, është i mirëpritur pranë QSP."

Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator

Qendra e Studimeve Parlamentare/Centre for Parliamentary Studies

Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15

Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214; cps@albaniaonline.net;

www.ascdpd.org